# INFORMATA MBI GRANTIN

| | |
|---|---|
| **Instrumenti:** | Grant Institucional |
| **Subjekti zbatues:** | Center for Social Group Development (CSGD) |
| **Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):** | Rr. Imzot Nike Prela 14, Prishtinë<br>info@csgd-ks.org<br>+383 (38) 728 417<br>www.csgd-ks.org |
| **Kohëzgjatja e grantit:** | Data e fillimit: 01/03/2026<br><br>Data e përfundimit: 31/12/2028 |
| **Buxheti i përgjithshëm i organizatës(EUR)** | EUR 721,806.50 |
| **Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):** | EUR 113,103.50 |
| **Grupet e synuara:** | LGBTIQ+ |
| **Shtrirja gjeografike:** | Gjithë Kosovën |
| **Përmbledhje e grantit:** | Përmes këtij granti, organizata synon të fuqizojë personat LGBTIQ+ në të gjithë Kosovën duke forcuar avokimin, lidershipin komunitar, ndërgjegjësimin publik dhe qasjen në shërbime të specializuara shëndetësore dhe psikosociale. CSGD synon të kontribuojë në një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në të drejtat e njeriut, duke përmirësuar reagimin institucional dhe duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të personave LGBTIQ+ në proceset qytetare dhe demokratike.<br><br>Përmes aktiviteteve avokuese, dialogut me institucionet dhe prodhimit të analizave dhe rekomandimeve për politika publike, organizata do të kontribuojë në zhvillimin e politikave më gjithëpërfshirëse. Në të njëjtën kohë, granti do të fuqizojë komunitetin përmes aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve, |

Bashkëfinancuar nga:

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Suedia
Sverige

| | |
|---|---|
| | nismave të udhëhequra nga të rinjtë, fushatave të ndërgjegjësimit publik dhe aktiviteteve të dukshmërisë që promovojnë diversitetin, barazinë dhe pjesëmarrjen demokratike.<br><br>Paralelisht, angazhimi i CSGD do të përmirësojë qasjen e personave LGBTIQ+ në shërbime të specializuara psikosociale dhe të shëndetit seksual e riprodhues, duke mbështetur veçanërisht grupet më të margjinalizuara brenda komunitetit. Një komponent i rëndësishëm i grantit është edhe forcimi i qëndrueshmërisë organizative përmes përmirësimit të sistemeve të brendshme të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit, si dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit të organizatës. Përmes kësaj qasjeje të integruar, GSGD synon të kontribuojë në përmirësime të qëndrueshme në mbrojtjen e të drejtave, mirëqenien dhe përfshirjen sociale të personave LGBTIQ+ në Kosovë. |